



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 713/2 prot.,

Datë 06.04.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “2N” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur punë*”, me Nr. REF-20964-03-01-2022, me objekt “*Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë*”, me fond limit 18,059,998.7 (tetëmbëdhjetëmilion e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Ankimues:

“2N” SHPK
Lagjia “Paskuqan Fushw”, Rruga “Demokracia”, Pallati nr. 2, kati parw, Pakuqan, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
Rruga “Dibrës”, Nr. 371, 1005-Tiranë.

Në datën 06.04.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 713 prot., e operatorit ekonomik “2N” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur punë*”, me Nr. REF-20964-03-01-2022, me objekt “*Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë*”, me fond limit 18,059,998.7 (tetëmbëdhjetëmilion e

pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “2N” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik, do të publikojë arsyet e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “2N” SHPK, kundërshton në ankesën me nr. 713 prot., datë 06.04.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Në zbatim të V.K.M. Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni Neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3, që citon: “Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike”, realizoi verifikimin, nga e cila rezultoi:

1. Operatori ekonomik “ 2 N “, NUIS: L31615017L ka paraqitur ofertë ekonomike (Shtojca 1) prej 14 811 688 (katërbëdhjetë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, pa tvsh.

2. Nga verifikimi i .“ Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit “ (Shtojca 2) , rezulton se oferta ekonomike e Operatorit ekonomik “ 2 N “, NUIS: L31615017L është prej 13 828 985 (trembëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë, pa tvsh.

3. Diferenca ndërmjet ofertës ekonomike të paraqitur dhe ofertës reale është prej + 982 703 lekë, pa T.V.SH., ose + 7.1 %.

Në zbatim të V.K.M. Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni Neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3. c, që citon:

”Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

si dhe të D.S.T.-së, F. VLERËSIMI I OFERTAVE, pika 22. Vlerësimi i ofertave dhe korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta, që citon: “Në çdo rast, Ofertat me gabime

aritmetike refuzohen kur: - vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 06.04.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Anëtar

Anëtar

Fiorent Zguro

Kreshnik Ternova

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri